

Prindërve që kërkojnë bashkim familjar me të mitur

Në Itali shkolla është e hapur për të gjithë, dhe nxënësit me origjinë të huaj kanë të drejtë dhe detyrë të shkojnë në shkollë duke filluar që nga mosha 6 vjeç. Prindërit duhet të shkruajnë në shkollën fillore e më pas në shkollën fillore të gradës së dytë nxënësin e duhet të kenë kujdes që të frekuentojnë leksionet. Mbas shkollës së gradës së dytë nxënësit duhet të zgjedhin shkollën e mesme me profile të ndryshme dhe kush nuk do të vazhdojë studimet mund të ndjekë kurset e formimit profesional ose të hyjë në punë nëpërmjet kontakteve që sigurojnë pjesmarrjen në aktivitete formative. Formimi i të rinjve duhet të vazhdojë deri në moshën 18 vjeç.

Shkolla italiane:

Çerdhe deri në 3 vjeç

Kopështi nga 3 deri në 6 vjeç

Shkolla fillore nga 6 deri në 11 vjeç

Shkolla e mesme nga 11 vjeç deri në 14 vjeç

Shkolla e mesme e shkollës së dytë mbas 14 vjeç

Hyrja në shkollë:

Viti shkollor fillon në mes të shtatorit e mbaron në mesin e muajit qershor. Nxënësit që arrijnë në Itali mund të regjistrohen në çdo moment të vitit shkollor por është e këshillueshme që sapo të jeni në dijeni të ardhjes së fëmijëve të kërkohet shkolla për të.

Në momentin e regjistrimit shkolla kërkon disa dokumenta:

- Lejen e qëndrimit (permesso di soggiorno)
- Një certifikatë për vaksinimet
- Dëftesën nga shkolla në Shqipëri

Mungesa e dokumentave nuk influencon në regjistrimin në shkollë, po nëse nuk i keni të gjitha këto dokumenta do t'ju duhen në momentin e bashkimit familjar.

Mund të sillni disa libra ose fletore nga shkolla e fëmijes tuaj, që ka frekuentuar në Shqipëri, pasi mund të jenë të nevojshme për mësuesit e shkollës, për të kuptuar më mire çfarë kanë studjuar dhe çfarë di të bëjë nxënësi i sapoardhur, mbi të gjitha atij do ti pëlqejë ti ketë këto materiale në shkollën e re.

Të mësuarit e italishtes në shkollë

Dhe nëse nuk di italisht, nxënësi i sapo ardhur regjistrohet në klasën që i korrespondon pa humbur asnjë vit shkollor. Në shumë shkolla ka mësues që ndihmojnë nxënësit me origjinë të huaj të mësojnë më kollaj gjuhën e huaj. Disa nxënës të shkollave në Firence mund të frekuentojnë kurset e alfabetizimit të hapura nga Bashkia. Për të mësuar italishten nuk është e nevojshme të harrohet gjuha e nënës, përkundrazi, një njohje sa më e thellë e gjuhës amëtare ndihmon në mësimin e shpejtë të gjuhës së huaj.